



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:020600
Datë: 10.01.2024
Numri i dokumentit: 05171699

C-IV-14-7687

Parashtruesi i kërkesës

R G, të cilën e përfaqëson zyra e avokatisë I A, përmes avokatit B I, Prishtinë.

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – (NSH "Banka Themelore e Kosovës" në likuidim), Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), gjyqtari Gazmend Sylaj, me 10 janar 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 29 dhjetor 2014, pranë DHPGJS, ankuesi parashtror kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN125-1018 datë 28 tetor 2014, (në tekstin e mëtutjeshëm: Vendimi), me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e pagave të papaguara, për periudhën prej 13 shtator 1990 gjer 1 korrik 1999, në shumë prej 81,600.00 (tetë një gjashtë zero zero) Euro, ndaj NSH "Banka Themelore e Kosovës" (në likuidim).

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e autorizimit për përfaqësuesin,
- Kopja e librezës së punës,
- Kopje të Vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, 1266/6 datë 14 dhjetor 1990,
- Kopja e listës përfundimtare të punëtorëve, të NSH, dhe

- Kopja e Vendimit të AL.

Me 17 tetor 2023, gjykata lëshoj një vërejtje për ankuesin mbi pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje ankuesi u informua se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Vërejtja e lartë cekur, ju dorëzua përfaqësuesit të ankuesit me 23 tetor 2023.

Gjer me datën e lëshimit të këtij vendimi taksat gjyqësore nuk janë paguar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS (Ligji nr. 06/L-086) parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Ankuesi komfor dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së *ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.*

Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh: *Në qoftë se paditësi/ja nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 17 tetor 2023, gjykata përmes vërejtjes kërkoj nga ankuesi, që të bëj pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore.

Ankuesit i është lejuar afati prej 15 ditësh që ta bëj pagesën e taksës gjyqësore. Sipas vlerësimit të gjykatës, ky është një afat i mjaftueshëm kohor.

Ankuesi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS-së në lidhje me udhëzimin e KGJK-së Nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Nga kjo gjykata konsideron se ankuesi nuk ka interes për çështjen juridike të tij dhe se në rastin konkret sipas dispozitave ligjore ankesa konsiderohet e tërhequr.

Gjykata nga gjitha arsyet e lartcekura nuk ndërmori veprime të mëtutjeshme procedurale si dhe nuk hyri në shqyrtim të çështjes.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar